



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR MIRËQENIEN SOCIALE
DREJTORIA E BARAZISË GJINORE

THIRRJE PUBLIKE PËR PËRZGJEDHJEN E PESË PËRFAQËSUESVE NGA ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË BARAZISË GJINORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 18, pika 2, shkronja “ë” të ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”, si dhe pikës 2, shkronja “ë” dhe pikës 3 të Urdhrit nr. 82, datë 29.04.2026 të Kryeministrit “Për ngritjen e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore”, ministri përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, me cilësinë e Kryetarit të këtij Këshilli, shpall thirrjen publike për përzgjedhjen dhe emërimin e pesë përfaqësuesve nga organizatat jofitimprurëse si anëtarë në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore, në bazë të një procedure të hapur konkurrimi.

Kjo thirrje synon të sigurojë përfaqësimin e organizatave jofitimprurëse aktive në fushën e barazisë gjinore në KKBGJ, në përputhje me parimin e përfaqësimit të balancuar dhe përfshirës, si dhe për të garantuar kontributin e shoqërisë civile në hartimin dhe monitorimin e politikave publike në këtë fushë.

I. KRITERET E PRANUESHMËRISË PËR ORGANIZATAT

Për qëllime të kësaj thirrje ftohen të aplikojnë organizatat jofitimprurëse që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Të jenë të regjistruara si organizata jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë;
- b) Të kenë në objekt të veprimtarisë çështjet e barazisë gjinore;
- c) Të kenë përvojë të dokumentuar në fushën e barazisë gjinore dhe/ose dhunës me bazë gjinore;
- ç) Të jenë aktive dhe të kenë realizuar aktivitete, projekte, studime ose analiza në fushën e barazisë gjinore;
- d) Të kenë kontribuar në procese të hartimit ose zbatimit të politikave publike;
- dh) Të kenë kapacitete për të kontribuar në procese këshillimore dhe ndërinstitucionale.

II. PROPOZIMI I PËRFAQËSUESVE

Organizatat aplikuese duhet të propozojnë përfaqësuesit e tyre për pjesëmarrje në KKBGJ, sipas këtyre rregullave:

- a) Çdo organizatë propozon deri në dy (2) kandidatë/kandidate;
 - b) Propozimet duhet të synojnë respektimin e parimit të përfaqësimit të balancuar gjinor;
 - c) Duhet të përcaktohet renditja e preferencës (preferenca e parë dhe e dytë);
 - ç) Kandidatët duhet të kenë integritet dhe eksperiencë në fushën e barazisë gjinore;
 - d) Kandidatët duhet të jenë të gatshëm të marrin pjesë aktive në veprimtarinë e KKBGJ-së.
- dh) Kandidatët duhet të jenë të njohur për shkak të veprimtarisë së tyre në fushën e barazisë gjinore dhe të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
- e) Kandidatët duhet të jenë përfshirë në diskutimet dhe të kenë dhënë kontribut gjatë proceseve të hartimit të strategjive kombëtare për barazinë gjinore;
- ë) Të kenë qenë pjesë aktive e fushatave ndërgjegjësuese, lobimeve për çështje të të drejtave të grave dhe barazisë gjinore

III. DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT

III.1 Për organizatën:

Organizatat e shoqërisë civile duhet të dorëzojnë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesë zyrtare për aplikim;
- Kopje e dokumentit të regjistrimit në Gjykatë
- Kopje të statutit të organizatës, *ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë së saj, zhvillimi i aktiviteteve në fushën e barazisë gjinore dhe/ose dhunës me bazë gjinore;*
- Vërtetim nga gjykata që tregon se organizata nuk është në proces shpërndarje, likuidimi ose falimenti, origjinal me afat brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit;
- Vërtetim nga organet tatimore që tregon se organizata nuk ka detyrime të papaguara me vule digjitale (i shkarkuar nga shërbimi www.e-albania.al), brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmia e penaltetit) ku tregohet se përfaqësuesi ligjor i organizatës nuk është dënuar me vendim të formës së prerë, me vule digjitale (i shkarkuar nga shërbimi www.e-albania.al), brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit
- Një raport përshkrues (CV), të projekteve dhe aktiviteteve të zbatuara nga organizata, ku të evidentohet gjithashtu përvoja me projektet dhe programet në fushën e barazisë gjinore;
- Tre referenca nga institucione, organizata me të cilat ka bashkëpunuar për çështjet e mësipërme.
- Dokumentacion mbështetës (projekte, raporte, publikime, etj.).

III.2 Për kandidatët e propozuar:

- Curriculum Vitae;
- Letër motivimi;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmia e penaltetit) ku tregohet se përfaqësuesi ligjor i organizatës nuk është dënuar me vendim të formës së prerë, me vule digjitale (i shkarkuar nga shërbimi www.e-albania.al), brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit
- Deklaratë pëlqimi për përfaqësim në KKBGJ, e nënshkruar nga kandidati/kandidatja; (shtojca A);
- Deklarata e shmangies së konfliktit të interesit (shtojca B),;
- Dokumentacion që vërteton eksperiencën në fushën e barazisë gjinore dhe/ ose dhunën me bazë gjinore
- Listë të aktiviteteve, projekteve, studimeve ose publikimeve relevante.

IV. PROCEDURA E PËRZGJEDHJES

Procesi i përzgjedhjes do të zhvillohet si më poshtë:

- a) Aplikimet shqyrtohen nga një komision i ngritur pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- b) Komisioni verifikon përmbushjen e kriterëve dhe vlerëson cilësinë e aplikimeve;
- c) Në përfundim të procesit të vlerësimit, Komisioni përzgjidh pesë (5) organizata jofitimprurëse dhe ia propozon Ministrit përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore.
- ç) Përzgjedhja e përfaqësuesve bëhet duke marrë në konsideratë propozimet e sjella nga vetë organizatat dhe duke garantuar balancë gjinore në përbërjen e KKBGJ-së;
- d) Organizatat e përzgjedhura njoftohen dhe konfirmojnë përfaqësuesin e tyre brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përzgjedhja.

V.DORËZIMI I APLIKIMEVE:

Aplikimet e plotësuara (me të gjithë dokumentet mbështetëse) duhet të dorëzohen **në 3 (tre) kopje fizike dhe 1 (një) kopje elektronike (USB)**, të vendosura në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar referenca e thirrjes publike, përmes postës zyrtare apo personalisht, gjatë ditëve të punës (e hëne – e premte) gjatë orarit zyrtar, në adresën në vijim:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,
Rruga e Kavajës, Tiranë, 1000,
Tiranë

Afati për dorëzimin e aplikimeve është data **11.06.2026, ora 16:30**. Aplikimet e dorëzuara pas këtij afati do të merren parasysh vetëm nëse vula postare tregon se data dhe koha e dërgimit kanë qenë para mbylljes së afatit zyrtar. Pjesa e jashtme e zarfit duhet të përmbajë **titullin e thirrjes për dorëzimin e aplikimeve, emrin dhe adresën e plotë të subjektit aplikues dhe mbishkrimin “Të mos hapet përpara hapjes zyrtare”**.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, rezultatet do të publikohen në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

MINISTER

Evis SALA



ANEKS A

DEKLARATË PËLQIMI PËR PËRFAQËSIM

Unë, i/e nënshkruari/a _____, deklaroj se jap pëlqimin tim për t'u propozuar dhe për të përfaqësuar organizatën _____ në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore (KKBGJ).

Deklaroj se do të përmbush me përgjegjësi detyrimet që rrjedhin nga ky përfaqësim.

Emër, Mbiemër: _____

Datë: _____

Nënshkrim: _____

ANEKS B

DEKLARATË PËR KONFLIKTIN E INTERESIT

Unë, i/e nënshkruari/a _____, deklaroj se:

- Nuk ndodhem në situatë konflikti interesi që do të ndikonte në ushtrimin e funksionit si anëtar/e i/e KKBGJ;
- Angazhohem të deklaroj çdo situatë të mundshme konflikti interesi në të ardhmen;
- Deklaroj se informacioni i paraqitur është i saktë dhe i plotë.

Emër, Mbiemër: _____

Datë: _____

Nënshkrim: _____